



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 160, Datë 17.06.2022

MBI

**REFUZIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “PPC ALBANIA” SH.A. PËR
RINOVIMIN E LICENCËS NR. 373, SERIA T17, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, 13, si dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 925/2, datë 14.06.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi refuzimin e kërkesës së shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.a. për rinovimin e licencës, me nr. 373, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 108, datë 19.05.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 373 Seria T17, të shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/20 prot., datë 20.05.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.06.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 478/1 prot., datë 01.06.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën “Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni”.
- Shoqëria “PPC ALBANIA” sh.p.k. nuk ka përcjellë asnjë përgjigje/shkresë në ERE përkundrejt shkresës nr. 478/1 prot., datë 01.06.2022.
- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin

juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “e”.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërma “d”.
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8, gërma “c”.

Dokumentacioni i konstatuar në mungesë është:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë). **Mungon vërtetimi i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për administratorin e shoqërisë.**

Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (vërtetimi për shlyerjen e tatimeve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore). **Konstatohet se shoqëria nuk ka depozituar vërtetimin përkatës për shlyerjen e detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.**
- **gërma “b”**(paraqitje bilanci financiar të tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)). **Nuk janë depozituar në ERE pasqyrat financiare të tri viteve të fundit ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë.**
- **gërma “c”** (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit). **Sikurse cituar edhe në fillimin e procedurës, shoqëria ka paraqitur një analizë financiare për 4 vite të veprimtarisë, për kostot e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike, por të pa shoqëruar me dokumentacionin financiar mbështetës për vlerat e parashikuara në këtë analizë financiare. Aktualisht shoqëria nuk ka depozituar dokumentacionin financiar mbështetës për veprimtarinë për të cilën kërkon të licencohet.**

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.8

- **gërma “a”** (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve). **Shoqëria ka paraqitur në formë tabelare sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë për 4 vite, ndërkohë që licenca për tregtimin e energjisë elektrike ka një afat 5-vjeçar.**

- **gërma “b”** (Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj). **Sikurse cituar edhe në nenin 9, pika 3, gërma “c”, shoqëria nuk ka depozituar sa kërkon kjo pikë e rregullores.**

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të refuzojë kërkesën e shoqërisë “PPC ALBANIA” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 373, Seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit nr. 93, datë 04.07.2017.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI